



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 75

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 24 maj 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10783, datë 17.5.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4691
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 5, datë 4.5.2018	Për përjashtimin nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit për operatorë të veçantë të biznesit ushqimor..... 4691
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 7, datë 15. 5.2018	Për kriteret dhe nivelin e vlerësimit, si dhe detajimi i pikësimit për të gjitha kategoritë ujore në ujërat e brendshme për procedurën e konkurrimit publik..... 4692
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 437, datë 9.5.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, të ndryshuar..... 4699
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 438, datë 9.5.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar..... 4703
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 189, datë 4.5.2018	Për miratimin e certifikatës shëndetësore veterinarë për mishin e kafshëve të llojit gjedhë, të imta, derra, të therura në thertore..... 4703
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 190, datë 4.5.2018	Për miratimin e certifikatës shëndetësore veterinarë që shoqëron lëvizjen dhe transportin e ngarkesave me lëkurë dhe produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor..... 4707
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 80, datë 4.5.2018	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për nxitjen e punësimit të rinjve nga grupe të veçanta”..... 4710

Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 81, datë 4.5.2018	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për nxitjen e biznesin rinor”.....	4712
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 8145, datë 17.5.2018	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes me Italinë.....	4715
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 8259, datë 18.5.2018	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes me Italinë.....	4715
Urdhër i kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 64, datë 22.5.2018	Për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë.....	4715
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Razmi Zekolli.....	4719

**DEKRET****Nr. 10783, datë 17.5.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Esat Reshat Mala
2. Diellor Agron Beseni
3. Olyvia Lynn Dean Alexander Paul Chaltas
4. Nikia Blair Michael Donn Withers
5. Jelena Krsto Nikpaljević
6. Lendita Rrahman Zeqiraj
7. Nehat Milazim Idrizi
8. Kamer Adem Qaka
9. Fadil Avdullah Vokri
10. Agim Qazim Ademi
11. Eroll Sali Salu
12. Albina Ragip Zyba
13. Rustem Reko Berisha
14. Ilirjana Shemsi Berisha (Dushullovci)
15. Akan Ismailhaki Ismaili
16. Afërdita Hakif Rexha Çollaku (Rexha)
17. Venera Abdul Osmani (Namani)
18. Mal Luan Osmani
19. Lindita Faik osmani (Hamiti)
20. Lekë Baton Osmani
21. Nita Fatos Daka (Goçi)
22. Endrit Hashim Thaçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM**Nr. 5, datë 4.5.2018****PËR PËRJASHTIMIN NGA ZBATIMI I
SISTEMIT TË VETËKONTROLLIT PËR
OPERATORË TË VEÇANTË TË
BIZNESIT USHQIMOR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 26, pika 7, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Kërkesë për përjashtim nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit mund të bëjnë operatorë të vegjël ushqimor që tregtojnë sasi të vogla produktesh ushqimore, kategori të veçanta operatorësh, si dhe prodhues të produkteve tradicionale.

2. Operatorë të vegjël ushqimor janë individë ose bashkim individësh të cilët shesin direkt për konsumatorin produktet e prodhuara prej tyre në sasi të vogla produktet primare dhe/ose të përpunuara me origjinë shtazore dhe joshtazore.

3. Shitje në sasi të vogla të konsiderohen:

- qumësht dhe produkte me bazë qumështi të shitur nga ferma që kanë jo më shumë se 3 (tre) krerë lopë;

- qumësht dhe produkte me bazë qumështi të shitur nga ferma që kanë jo më shumë se 30 krerë të imta;

- pula të gjalla dhe vezë të shitura nga ferma me jo më shumë se 50 krerë pula;

- mjaltë nga ferma me jo më shumë se 30 koshere;

- pastërma e përftuar nga ferma që kanë jo më shumë se 3 (tre) krerë lopë dhe/ose jo më shumë se 30 krerë të imta;

- fruta dhe perime të freskëta, si dhe produkte të përpunimit të tyre nga ferma familjare;

- produkte ushqimore të prodhuara në mënyrë artizanale sipas traditës së zonës.

4. Operatorët e biznesit ushqimor të përcaktuar në pikën 1 i shesin produktet e tyre brenda territorit të njësisë administrative në të cilën ushtrojnë aktivitetin. Ato mund të tregtohen direkt te konsumatori i fundit, në portën e fermës së tij, në tregun lokal, në rrjetin e dyqaneve “EDUA”, restorantet, bujtinat e



hotelet brenda territorit të njësisë administrative. Produktet primare shiten direkt në evente të tilla, si: tregje ditore, panaire, festa fetare etj.

5. Operatorët sipas pikës 11 të këtij udhëzimi mbajnë të dhëna për gjurmueshmërinë e ushqimit nga prodhuesi te konsumatori.

6. Operatorët e biznesit ushqimor të cituar në pikën 1, të cilët duan të listohen sipas pikës 11, paraqesin një kërkesë me shkrim pranë MBZHR-së. Kërkesa duhet të përmbajë:

- Emër, mbiemër;
- Adresa;
- Llojin dhe sasinë e produkteve të prodhuara;
- Llojin dhe sasinë e produkteve që kërkon të shesë;
- Vendin e shitjes së produkteve

7. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, MBZHR-ja shqyrton kërkesën dhe ja përcjellë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) për të verifikuar nëse operatori garanton një nivel të pranueshëm higjienik në zbatim të sistemit të procedurave të vetëkontrollit, sipas praktikave të mira të kontrollit.

8. AKU-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga marrja e kërkesës, kryen verifikimin për kushtet higjienike dhe dërgon në Ministri raportin mbi verifikimin e kryer.

9. Ministria shqyrton raportin e ardhur nga AKU-ja dhe sipas rastit liston ose jo aplikuesin në listën e bizneseve të përjashtuara nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit. Në të dyja rastet, Ministria njofton aplikuesin.

10. Ministria shqyrton të gjitha rastet e ankesave nga aplikuesit.

11. Operatorët e biznesit ushqimor që plotësojnë kërkesat e këtij udhëzimi përjashtohen nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit dhe listohen në listën, modeli i së cilës jepet në Shtojcën I bashkëlidhur këtij udhëzimi. Përditësimi i listës së operatorëve të biznesit ushqimor të përjashtuar nga sistemi i vetëkontrollit bëhet rast pas rasti.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi

SHTOJCË I

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i aktivitetit	Adresa	Sasia e produktit të shitur për lloj produkti	Vendi i shitjes së produktit

UDHËZIM Nr. 7, datë 15. 5.2018

PËR KRITERET DHE NIVELIN E VLERËSIMIT, SI DHE DETAJIMI I PIKËSIMIT PËR TË GJITHA KATEGORITË UJORE NË UJËRAT E BRENDSHME PËR PROCEDURËN E KONKURRIMIT PUBLIK

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 32, dhe të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, si dhe pikës 19, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.7.2013 “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit

publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I PROCEDURA E KONKURRIMIT

1. Procedurat e konkurrimit publik për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit, kryhet nga Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave, i ngritur me urdhër ministri, i cili ka detyra të përcaktuara në VKM-në nr. 712, datë 31.7.2013, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.



2. Drejtoria që mbulon peshkimin, grumbullon, regjistron e verifikon kërkesat e ardhura për zhvillim aktiviteti të peshkimit sipas zonave ujore. Zonat ujore, pasi seleksionohen dhe kategorizohen, renditen në listën për shpallje për konkurrim publik. Për zonat ujore kur nuk ka kërkesa për zhvillim aktiviteti, ministria njofton bashkinë/drejtorinë e ujitjes dhe të kullimit për shpalljen e konkurrit publik për ujëmbledhësin përkatës. Kur institucioni që administron ujëmbledhësin nuk përgjigjet brenda 45 ditëve për këtë njoftim, ministria shpall konkurrimin.

3. Drejtoria që mbulon peshkimin krijon një *data-bazë* elektronikë të të gjitha kërkesave të ardhura duke specifikuar emrin e kërkuarit, datën, zonën, llojin e aktivitetit të kërkuar, si dhe mbylljen e praktikës.

4. Njoftimi për botim për konkurrim publik për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit shpallet 2 herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban të dhënat për zonën ujore, pikët vlerësuese për elementet e konkurrit, dokumentacionin (plan-biznesin) që duhet të paraqesin konkurrentët, si dhe vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrit të jetë jo më parë se 7 (shtatë) ditë kalendrike nga data e botimit të fundit.

5. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA), mban një listë (që përditësohet vazhdimisht) të subjekteve që rezultojnë kundërvajtës i legjislacionit në fushën e peshkimit dhe/ose debitorë, me qëllim që të mbahet parasysh në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit për konkurrim nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Kërkesave.

6. Lista finale e objekteve ujore e përgatitur nga drejtoria që mbulon peshkimin, si dhe lista e subjekteve fituese, dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike nëpërmjet Sektorit të Prokurimeve Publike.

KREU II

KËRKESAT DHE DOKUMENTACIONI PËR SUBJEKTET KONKURRUES

7. Të gjitha subjektet e interesuara që paraqiten për konkurrim, sipas kategorive ujore të shpallura dhe llojit të aktivitetit, duhet të paraqesin në ministri një plan-biznes të plotë për zhvillimin e veprimtarisë së synuar, duke përfshirë të dhëna personale të subjektit, si:

NIPT-i, ID-ja, numri i kontaktit, si dhe të dhëna për nivelin e investimit e të punësimit, duke konsideruar statusin mjedisor të zonës, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Dokumentacioni (plan-biznesi) i kërkuar sipas pikës 7 të këtij udhëzimi, duhet të paraqitet nga subjektet e interesuara në adresën e mëposhtme: “Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, Tiranë, në zyrën e protokollit të kësaj ministrie. Zarfë të jetë i mbyllur me mbishkrimin: “Për konkurrim publik” (emri i zonës ujore dhe kategorisë për të cilën bëhet kërkesa), si dhe të mos hapet përpara datës dhe orës në të cilën është caktuar konkurrimi për zonën dhe kategorinë ujore në fjalë.

9. Për qëllime identifikimi, aplikuesi sipas statusit përkatës (person fizik/ juridik), duhet të paraqitet para Komisionit të Vlerësimit të Kërkesave me kartë identiteti/ pasaportë biometrike. Në rastet kur personi përfaqëson një subjekt fizik/ juridik, ai duhet të jetë i pajisur me prokurë të nënshkruar nga personi që kërkon të përfaqësohet.

KREU III

KRITERET E KONKURRIMIT DHE TË VLERËSIMIT

10. Kriteret e konkurrit, për të gjitha kategoritë ujore, janë:

a) Niveli i investimit, në raport të drejtë me kapacitetet dhe resurset e zonës ku do të zhvillohet aktiviteti;

b) Niveli i prodhimit;

c) Niveli i punësimit;

d) Në rast klasifikimi me pikë të barabarta, eksperiencia në aktivitetin për të cilin konkurrohet ka përparësi.

11. Nivelet e vlerësimit, shprehur me pikë:

Nivelet maksimale të vlerësimit, për të gjitha kategoritë ujore, janë:

a) Niveli i investimit 40 pikë;

b) Niveli i prodhimit 30 pikë;

c) Niveli i punësimit 30 pikë.

Vlerësimi me pikë do të realizohet sipas formulës në aneksin 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.



KREU IV DETYRAT E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË KËRKESAVE

12. Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave, në përmbushje të detyrimeve të tij, kryen procedurat e mëposhtme:

a) Hap, në prani të konkurrentëve, zarfin me dokumentacionin e paraqitur prej tyre, duke bërë të njohura të dhënat kryesore që përmban dokumentacioni i dorëzuar.

b) Verifikon për subjektin konkurrues:

i) nëse është i regjistruar në QKB, përfshirë NIPT/NUIS dhe ekstraktin historik të subjektit fizik/juridik (nëpërmjet faqes zyrtare të QKB-së);

ii) verifikon, nëpërmjet DSHPA-së, nëse subjekti kërkues është dënuar ose jo, nëse është në procedurë për shkelje ligjore në peshkim dhe/ose është debitor.

c) Kryen procesin e vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur edhe në rastin kur për objektin ujon të shpallur për konkurrim është paraqitur një konkurrues i vetëm, sipas tabelës për kriteret dhe nivelin e vlerësimit, në aneksin 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

ç) Harton procesverbalin e zhvillimit të procedurës së konkurrit, ku përshtkruhen pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit, si dhe renditjen e subjekteve të kualifikuara sipas vlerësimit me pikë.

d) Shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike dhe vlerëson me pikë sipas çdo elementi konkurrimi dhe përcaktimeve të shpallura në njoftim.

dh) Para lidhjes së kontratës me subjektin fitues, verifikon *online*:

- vërtetimin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për tatimpaguesit E-Sig 02a;

- vërtetimin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për individët, formulari E-Sig 03a;

- vërtetimin për shlyerjen e tatimeve dhe taksave;

- vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penaltetit).

e) Paraqet te ministri, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “d” të kësaj pike,

raportin përmbledhës për zhvillimin e konkurrit, së bashku me procesverbalin e vlerësimit dhe listën e konkurruesve, të renditur sipas pikëve të fituara, për të kërkuar miratimin e procedurës.

ë) Pas miratimit të raportit përmbledhës, Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave i paraqet ministrit njoftimin e fituesit, për të vijuar me nënshkrimin e kontratës me subjektin fitues.

f) Shpall subjektin/et fitues/e. Njoftimi për shpalljen e fituesve vendoset në këndin e njoftimeve të ministrisë, si dhe dërgohet për publikim në Buletinën e Njoftimeve Publike.

KREU V DISPOZITAT E FUNDIT

13. Pas përfundimit të procedurave të sipërpërmendura, titullari i institucionit ose i deleguari prej tij, lidh kontratën për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar dhe të miratuar në procesin e konkurrit me subjektin fitues brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së fituesit në Buletinën e Njoftimeve Publike.

14. Kontratat për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit përgatiten nga drejtoria që mbulon peshkimin, sipas modelit të kontratës tip të miratuar me urdhër ministri. Zbatimi i kushteve të vendosura në kontratë, është objekt monitorimi nga grupi i punës i ngritur me urdhër ministri.

15. Udhëzimi nr. 3, datë 10.2.2015, “Për kriteret dhe nivelin e vlerësimit, si dhe detajimi i pikësimit për të gjitha kategoritë ujore në ujërat e brendshme për procedurën e konkurrit publik”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

16. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave, drejtoria që mbulon peshkimin në MBZHR dhe DSHPA ,për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi



ANEKSI 1 MODELI STANDARD I HARTIMIT TË PLAN-BIZNESIT

A. PJESA PËRSHKRUESE E PLANIT TË BIZNESIT

1. HISTORIKU I AKTIVITETIT EKZISTUES

1.1 Aktiviteti tregtar, nëse ka.

.....

1.2 Struktura e pronësisë.

.....

1.3 Përshkrim i burimeve të financimit.

.....

1.4 Niveli i punësimit.

.....

1.5 Performanca e aktivitetit nëse ka për tri vitet e fundit, si dhe perspektiva e së ardhmes për biznesin në fjalë.

.....

2. PËRSHKRIMI I PROPOZIMIT

2.1 Paraqitni me një përshkrim të shkurtër një panoramë të përgjithshme të propozimit dhe shpjegoni arsyet tuaja përse dëshironi të merrni përsipër projektin.

.....

2.2 Analiza e tregut të peshkut.

.....

2.3 A keni kontrata ekzistuese apo parashikoni të lidhni kontrata për shitjen e peshkut?

.....

2.4 Niveli i punësimit dhe aftësitë e nevojshme.

.....

2.5 Legjislacioni i zbatueshëm për këtë investim/aktivitet peshkimi/akuakulture.

.....

2.6 Përshkrim i riskut të këtij investimi/aktiviteti.

.....

3. PROJEKTI TEKNIK I INVESTIMIT TË PROPOZUAR

3.1 Teknologjia, procesi i prodhimit të propozuar dhe niveli i zënies/prodhimit peshkut.

.....

3.2 Ndërtimi/rikonstruksioni, nëse ka.

.....

3.3 Pajisjet e nevojshme.

.....

4. DETAJET FINANCIARE TË PROJEKTI TË RI TË PROPOZUAR

4.1 Përmbledhje e kostove dhe financimit.

.....

4.2 Komente për parashikimet e të ardhurave dhe fitimit.

.....

A. UDHËZIM MBI PLOTËSIMIN E PJESËS PËRSHKRUESE TË PLANIT TË BIZNESIT

1. HISTORIKU I AKTIVITETIT EKZISTUES

1.1 Aktiviteti tregtar aktual i aplikantit.

- Përshkruani shkurtimisht aktivitetin ekzistues, përfshirë tregun e produktit peshkor dhe përcaktoni konsumatorët tuaj kryesorë.

- Përshkruani kontratat ekzistuese me blerësit.



- Përshkruani konkurrentët tuaj kryesorë dhe pozicionin tuaj në treg.
- Përshkruani shkurtimisht sasinë e peshkut që do të prodhoni/peshkuar, vëllimin ekzistues të shitjeve dhe çmimet mesatare të marra.

1.2 Struktura e pronësisë.

- Shpjegoni dhe paraqisni një listë të shoqërive që kanë lidhje pronësie me aktivitetin/biznesin tuaj, të cilat janë të lidhura ngushtë me funksionimin e aktivitetit tuaj ekzistues nëse ka.

1.3 Përshkrimi i burimeve të financimit.

- Përshkruani dhe paraqisni garancitë financiare, që kanë lidhje me aktivitetin dhe që garantojnë zbatimin e detyrimeve të investimeve të marra përsipër.

1.4 Niveli i punësimit.

- Numri total i të punësuarve me kohë të plotë, si dhe numri i të punësuarve me kohë të pjesshme dhe sezonale.

- Përshkruani strukturën e drejtimit të biznesit.

1.5 Performanca e aktivitetit për tri vitet e fundit, si dhe perspektiva e së ardhmes për biznesin në fjalë.

- Jepni përshkrime të nivelit të performancës financiare të kohëve të fundit.
- Për bizneset e regjistruara në organet tatimore, analizoni shkurtimisht informacionin e bilancit dhe pasqyrës së ardhurave dhe shpenzimeve për tri vitet e fundit, që janë dorëzuar së bashku me formularin e aplikimit.

- Në rast se individ/ishoqëria nuk ka të dhëna të historikut financiar për të paraqitur për tri vitet e fundit, atëherë ai/ajo duhet të paraqesë çdo informacion të disponueshëm mbi veprimtarinë e biznesit (p.sh., të vitit të kaluar).

- Në rast se aplikuesi nuk është i regjistruar pranë autoriteteve tatimore (në përputhje me legjislacionin në fuqi) ai mund ta lërë bosh këtë seksion.

2. PROJEKTI I INVESTIMIT TË RI TË PROPOZUAR

2.1 Paraqitni me një përshkrim të shkurtër një panoramë të përgjithshme të investimit të ri, si dhe shpjegoni arsyet tuaja përse dëshironi të merrni përsipër projektin.

- Përshkruani shkurtimisht llojin e aktivitetit, procesin e prodhimit dhe rezultatet përfundimtare të pritshme aty ku është e mundur.

- Shpjegoni synimin përse dëshironi të ndërmerri këtë projekt.

2.2 Analiza e tregut të prodhimit peshkor.

Lutemi të merrni parasysh çështjet e mëposhtme nëse do të zhvillohet/paraqitet një produkt peshkor cilësor në bazë të investimit të ri:

- Përshkruani natyrën dhe përmasat e tregut për produktin peshkor dhe përcaktoni konsumatorët tuaj kryesorë;

- Çmimet e produktit peshkor që do të peshkohet/prodhohet krahasuar me tregun;

- Përshkruani marrëveshjet e parapake me blerësit për prodhimin peshkor të peshkuar/prodhuar si rezultat i investimit, nëse ka;

- Përshkruani konkurrentët tuaj kryesorë dhe se si keni ndërmend të konkurroni me ta.

2.3 A keni kontrata ekzistuese apo parashikoni të lidhni kontrata për shitjen e produktit peshkor?

- Përshkruani shkurtimisht kontratat ekzistuese apo ato potenciale në lidhje me investimin tuaj, nëse ka.

2.4 Niveli i punësimit dhe aftësitë e nevojshme.

- Shpjegoni cilat janë aftësitë e nevojshme për ta bërë këtë propozim të suksesshëm dhe se si ju synoni t'i siguron këto aftësi.

- Nëse synoni të punësoni staf të ri lutemi të përshkruani numrin, eksperiencën dhe kualifikimet që ata duhet të kenë.

2.5 Legjislacioni i zbatueshëm për këtë investim.

- Rëndisni legjislacionin që zbatohet për këtë aktivitet të zënies/prodhimit të peshkut dhe përshkruani hapat që ju do të ndërmerri për të siguruar që aktiviteti juaj të jetë i pajtueshëm me të.



- Evidentoni dhe përshkruani lejet/ licencat/certifikatat/ patentat etj., të nevojshme për zbatimin e investimit të ri dhe ushtrimin e aktivitetit.

2.6 Përshkrim i riskut të investimit.

- Identifikoni dhe përshkruani fushat kryesore të riskut brenda projektit tuaj dhe ndikimin që këto mund të kenë në suksesin e projektit të ri.

- Përshkruani çfarë do të bëni ju për të zbutur/minimizuar ndikimin e këtyre risqeve.

- Përshkruani ndikimet sociale të investimit të ri mbi aktivitetin tuaj dhe komunitetin e gjerë nëse ka.

3. PËRSHKRIMI TEKNIK

3.1 Teknologjia, procesi i prodhimit të propozuar dhe niveli i zënies/prodhimit të peshkut, kjo e lidhur/shprehur me efektivitetin në sasi peshku i peshkuar/prodhuar dhe i shitur.

- Përshkruani teknologjinë që do të futet në përdorim, kapacitetin e saj, si dhe arsyet për të cilat ky kapacitet është përzgjedhur në lidhje me lëndët e para që keni në dispozicion (rasate peshku, rrjeta peshkimi etj.).

- Përshkruani sasinë e peshkut që mund të peshkoni/prodhoni gjatë kryerjes së këtij investimi sipas viteve.

- Nëse aktiviteti i zënies/prodhimit të peshkut kërkon kohë për të arritur që të shfrytëzohen me kapacitet të plotë, kjo duhet të shpjegohet në mënyrë të qartë. Për shembull, në vitin 1 pas nënshkrimit të kontratës, kapaciteti i shfrytëzuar është ____%, në vitin 2 arrin në ____% dhe në vitin 3 ____% e me radhë deri kur arrin shfrytëzimin e plotë të kapacitetit. Ky përshkrim duhet të përgatitet për mjetet e veglat që përdoren për zënie/prodhimin e peshkut, pajisjet dhe punimet e ndërtimit që propozohen.

3.2 Ndërtimi/ rikonstruksioni nëse ka.

- Paraqisni një përshkrim përmbledhës të ndërtimit/ rikonstruksionit të planifikuar. Ndërtimet/ rikonstruksionet duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e peshkimit/ akuakulturës dhe atë mjedisore.

3.3 Pajisjet e nevojshme.

- Paraqisni një listë të mjeteve/ veglave e pajisjeve të nevojshme që iu duhen për zhvillimin e aktivitetit të zënies/ prodhimit të peshkut.

4. DETAJET FINANCIARE TË PROJEKTIT TË RI TË PROPOZUAR

4.1 Përmbledhje e kostove dhe financimit.

- Lutemi të paraqisni një përmbledhje të totalit të kostove të investimit të propozuar.

4.2 Komente për parashikimin e të ardhurave dhe fitimit.

- Fluksi i parave të pasqyrat financiare synon të tregojë performancën financiare në lidhje me investimet që do të kryhen.

- Në rastet kur një aktivitet i zënies/ prodhimit të peshkut ekzistues do të zhvillohet me pritmërinë se do të krijojë të ardhura shtesë, është e nevojshme të paraqitet informacion financiar për aktivitetin ekzistues përpara investimit dhe më pas të planifikohen flukset financiare pas investimit. Kjo do t'ju lejojë të dalloni fazat përpara dhe pas dhe kështu të tregoni të ardhurat e krijuara nga investimi i ri apo nga përdorimi i teknologjive të reja në aktivitetin që do të kryeni.

- Rezultatet e analizës së të ardhurave dhe analizës së shpenzimeve për investimin e aktivitetit të zënies/ prodhimit të peshkut për të cilin aplikoni për konkurrim publik, duhet të formojnë bazën për planifikimin e flukseve të reja të parave, që iu nevojiten për vazhdimësinë e këtij aktiviteti.



ANEKSI 2 KRITERET PËR KONKURRIMIN PUBLIK

I. Kriteret e konkurrimit, për të gjitha kategoritë ujore, janë:

- a) Niveli i investimit, në raport të drejtë me kapacitetet dhe resurset e zonës ku do të zhvillohet aktiviteti;
- b) Niveli i prodhimit (impakti i investimit i shprehur me sasinë e peshkut që do të peshkojë/prodhuar);
- c) Niveli i punësimit.

Në rast klasifikimi me pikë të barabarta, eksperiencia në aktivitetin për të cilin konkurrohet ka përparësi.

II. Nivelet e vlerësimit:

Nivelet maksimale të vlerësimit për të gjitha kategoritë ujore (NMax) 100 pikë

- Vlerësimi sipas kriterëve:

- a) Niveli i investimit (NV) 40 pikë;
- b) Niveli i prodhimit (NPr) 30 pikë;
- c) Niveli i punësimit (NP) 30 pikë.

III. Vlerësimi i aplikimeve:

$N_{Max} = NI + NPr + NP$

ku:

N_{Max} - janë pikët totale të vlerësimit të kriterëve të pasqyruara në plan-biznes.

$NI/NPr/NP$ - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar (niveli i investimi/ niveli i prodhimit/ niveli i punësimit).

Pikët për çdo kriter përlogariten sipas formulës:

Vlera më e madhe e investimit/ prodhimit/ punësimit 100 pikë

Vlera më e vogël e investimit/ prodhimit/ punësimit X pikë

$$X(NI/NPr/NP) = \frac{\text{Vlera më e vogël e investimit/ prodhimit/ punësimit} \times 100}{\text{Vlera më e madhe e investimit (në lekë)}}$$

Niveli i investimit (NI) (max 40 pikë)

Vlera më e madhe e investimit (në lekë) 40 pikë

Vlera më e vogël e investimit (në lekë) X pikë

$$X(NI) = \frac{\text{Vlera më e vogël e investimit} \times 100}{\text{Vlera më e madhe e investimit (në lekë)}}$$

Niveli i prodhimit (max 30 pikë)

Sasia më e madhe e peshkut të prodhuar (i deklaruar në plan-biznes) 30 pikë

Sasia më e vogël e peshkut të prodhuar (i deklaruar në plan-biznes) X pikë

$$X(NPr) = \frac{\text{Sasia më e vogël e peshkut të prodhuar (i deklaruar në plan-biznes kv)} \times 100}{\text{Sasia më e madhe e peshkut të prodhuar (i deklaruar në plan-biznes kv)}}$$

Niveli i punësimit (max 30 pikë)

Numri maksimal i të punësuarve (i deklaruar në plan-biznes) 30 pikë

Numri minimal i të punësuarve (i deklaruar në plan-biznes) X pikë

$$X(NP) = \frac{\text{Numri minimal i të punësuarve (i deklaruar në plan-biznes)} \times 100}{\text{Numri maksimal i të punësuarve (i deklaruar në plan-biznes)}}$$



UDHËZIM

Nr. 437, datë 9.5.2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË UDHËZIMIN NR. 5628, DATË
18.11.2016, “PËR MIRATIMIN E RRJETIT
TË LINJAVE NDËRQYTETËSE”,
TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 16 dhe 19, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Neni 1 i udhëzimit ndryshon si më poshtë:

Qëllimi i këtij udhëzimi është miratimi i rrjetit të linjave ndërqytetëse (kryesore dhe ushqyese), i cili përfshin itineraret e udhëtimit, sipas aneksit 1 dhe aneksit 2, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Neni 2

Neni 3 i udhëzimit ndryshon si më poshtë:

1. Linja ndërqytetëse përfshin pikën e nisjes (vendi i nisjes), itinerarin dhe pikën e mbërritjes (vendi i mbërritjes).

2. Transporti në linjat kryesore kryhet pa ndalime për hipjen apo zbritjen e udhëtarëve gjatë itinerarit të linjës.

3. Transporti në linjat ushqyese kryhet pa ndalime për hipjen apo zbritjen e udhëtarëve në stacione gjatë itinerarit të linjës, në përputhje me rrjetin e linjave.

4. Pika e nisjes (vendi i nisjes) dhe pika e mbërritjes (vendi i mbërritjes) është qyteti qendër bashkie dhe/ose qyteti që është në përbërje të bashkisë.

Neni 3

1. Pika 1, neni 6, e udhëzimit, ndryshon si më poshtë:

“1. Ministri miraton shtimin, heqjen ose ndryshimin e linjave ndërqytetëse, në mbështetje të nevojave të lëvizjes së udhëtarëve për, në, ose nga bashkitë dhe destinacionet dimërore apo verore dhe qendrat historike, pas kërkesës së argumentuar të bashkisë përkatëse.”.

2. Pika 2, neni 6, i udhëzimit, ndryshon si më poshtë:

“2. Komisionin Vlerësues, i miratuar me urdhër ministri, me përbërje nga drejtoria përgjegjëse e politikave të transportit, drejtoria përgjegjëse e licencimit dhe drejtoria përgjegjëse për çështjet juridike, bën shtimin dhe heqjen e numrit të orareve të linjave ndërqytetëse, në mbështetje të nevojave të lëvizjes së udhëtarëve, pas kërkesës së argumentuar të bashkisë përkatëse, si dhe kërkesës së subjektit të licencuar në linjën e rregullt ndërqytetëse.”.

Neni 4

Në rrjetin e linjave ndërqytetëse, të përcaktuara në aneksin 1, të udhëzimit nr. 5628, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, shtohen linjat ndërqytetëse sipas shtojcës A të këtij udhëzimi.

Neni 5

Në rrjetin e linjave ndërqytetëse të përcaktuara në aneksin 2, të udhëzimit nr. 5628, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, shtohet linja ndërqytetëse Tiranë–Vorë–Tiranë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjijnuri

**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE****SHTOJCA A****QARKU BERAT****RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË BERAT**

Nr.	LINJA KRYESORE
1	BERAT–GRAMSH–BERAT

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË KUÇOVË

Nr.	LINJA KRYESORE
1	KUÇOVË–SHKODËR–KUÇOVË
2	KUÇOVË–LIBRAZHD–KUÇOVË

QARKU DIBËR**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË BULQIZË**

Nr.	LINJA KRYESORE
1	BULQIZË–ELBASAN–BULQIZË

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË PESHKOPI

Nr.	LINJA KRYESORE
1	PESHKOPI–KAMZË–PESHKOPI

QARKU DURRËS**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË DURRËS**

Nr.	LINJA USHQYESE
1	DURRËS–GOLEM–DURRËS
2	GOLEM–DURRËS–GOLEM

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË SHIJAK

Nr.	LINJA KRYESORE
1	SHIJAK–PESHKOPI–SHIJAK
2	SHIJAK–LIBRAZHD–SHIJAK

QARKU ELBASAN**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË BELSH**

Nr.	LINJA USHQYESE
1	BELSH - LIBRAZHD - BELSH

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË CËRRIK

Nr.	LINJA KRYESORE
1	CËRRIK–SARANDË–CËRRIK
2	CËRRIK–BERAT–CËRRIK

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË ELBASAN

Nr.	LINJA KRYESORE
1	ELBASAN–SHKODËR–ELBASAN

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË GRAMSH

Nr.	LINJA KRYESORE
1	GRAMSH–KAMZË–GRAMSH

**QARKU FIER****RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË DIVJAKË**

Nr.	LINJA KRYESORE
1	DIVJAKË–LIBRAZHID–DIVJAKË

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË LUSHNJË

Nr.	LINJA KRYESORE
1	LUSHNJË–KORÇË–LUSHNJË
2	LUSHNJË–LIBRAZHID–LUSHNJË

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË MALLAKASTËR

Nr.	LINJA KRYESORE
1	BALLSH–SARANDË–BALLSH
2	BALLSH–VLORE–BALLSH

QARKU GJIROKASTËR**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË DROPULL**

Nr.	LINJA KRYESORE
1	DROPULL–TIRANË–DROPULL

Nr.	LINJA USHQYESE
1	DROPULL–GJIROKASTËR–DROPULL

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË GJIROKASTËR

Nr.	LINJA KRYESORE
1	GJIROKASTËR–DROPULL–GJIROKASTËR

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË KËLCYRË

Nr.	LINJA KRYESORE
1	KËLCYRË–TIRANË–KËLCYRË

Nr.	LINJA USHQYESE
1	KËLCYRË–PËRMET–KËLCYRË

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË MEMALIAJ

Nr.	LINJA KRYESORE
1	MEMALIAJ–SARANDË–MEMALIAJ

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË PËRMET

Nr.	LINJA KRYESORE
1	PËRMET–DURRËS–PËRMET
2	PËRMET–SARANDË–PËRMET

QARKU KUKËS**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË KUKËS**

Nr.	LINJA KRYESORE
1	KUKËS–ELBASAN–KUKËS
2	KUKËS–KAMZË–KUKËS

**QARKU TIRANË****RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË KAMZË**

Nr.	LINJA KRYESORE
1	KAMZË–GRAMSH–KAMZË
2	KAMZË–POGRADEK–KAMZË

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË RROGOZHINË

Nr.	LINJA KRYESORE
1	RROGOZHINË – ELBASAN– RROGOZHINË

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË TIRANË

Nr.	LINJA KRYESORE
1	TIRANË–KONISPOL–TIRANË
2	TIRANË–MALIQ–TIRANË
3	TIRANË–MEMALIAJ–TIRANË
4	TIRANË–PATOS–TIRANË
5	TIRANË–ROSKOVEC–TIRANË
6	TIRANË–DROPULL–TIRANË
7	TIRANË–KËLCYRË–TIRANË
8	TIRANË–SELENICË–TIRANË
9	TIRANË–KLOS–TIRANË

QARKU VLORË**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË HIMARË**

Nr.	LINJA KRYESORE
1	HIMARË–DROPULL–HIMARË
2	HIMARË–FIER–HIMARË

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË SARANDË

Nr.	LINJA KRYESORE
1	SARANDË–KORÇË–SARANDË

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË SELENICË

Nr.	LINJA KRYESORE
1	SELENICË–TIRANË–SELENICË

RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE

Shtesë

ANEKSI 2

QARKU TIRANË**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE PËR BASHKINË TIRANË**

Nr.	LINJA KRYESORE
1	TIRANË–VORË–TIRANË

**UDHËZIM****Nr. 438, datë 9.5.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË UDHËZIMIN NR. 5627, DATË
18.11.2016, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, RREGULLAVE DHE
DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN
E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË
TRANSPORTIN RRUGOR TË
UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 5 dhe 17, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Pas paragrafit të dytë të pikës 2, të nenit 6, shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht nga përcaktimet e paragrafit të dytë, të pikës 2 të këtij neni, licencat për shërbimin e rregullt në transportin ndërqytetës të udhëtarëve, që do të lëshohen pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të kenë afat deri më 31 mars 2022.

Paragrafi i dytë i pikës 6, të nenit 6, ndryshohet si më poshtë:

“Licenca për shërbimet e rregullta të udhëtarëve lëshohet e shoqëruar me numrin e nevojshëm të certifikatave të operimit të mjeteve. Një subjekt pajiset me certifikatat e operimit për mjetet që ka kërkuar, duke plotësuar numrin e nevojshëm të mjeteve që duhet për operimin në linjat e kërkuara. Në rast se subjekti i licencuar aplikon për të zëvendësuar mjet, certifikata lëshohet vetëm në rast se provohet që mjeti për të cilën kërkohet certifikata është ekuivalent në vit prodhimi dhe cilësi me mjetin me të cilin subjekti ka aplikuar për licencë sipas nenit 9 të

këtij udhëzimi. Në rast se subjekti i licencuar aplikon për të shtuar mjet, certifikata lëshohet vetëm në rast se mjeti është me vit prodhimi më së paku ekuivalent me mjetin më të ri me të cilin operon subjekti.

Numri i mjeteve në transportin e udhëtarëve në linja të rregullta dhe ndryshimi i orareve, përcaktohet nga zyra e licencave në bazë të frekuencës së udhëtimeve, distancës së udhëtimit dhe mjeteve rezervë që duhet të ketë subjekti transportues.”.

Neni 2

Paragrafi i parë, pika 6, i nenit 11, ndryshohet si më poshtë:

“6. Autoriteti përgjegjës i licencimit, nëpërmjet një Komisioni Vlerësues të përcaktuar nga titullari, me përbërje nga drejtoria përgjegjëse e politikave të transportit, drejtoria përgjegjëse e licencimit dhe drejtoria përgjegjëse për çështjet juridike, për zgjedh me konkurs të hapur, subjektin kandidat për të operuar në një linjë të rregullt ndërqytetës udhëtarësh, në rastet kur:”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjijnuri**

URDHËR**Nr. 189, datë 4.5.2018**

**PËR MIRATIMIN E CERTIFIKATËS
SHËNDETËSORE VETERINARE PËR
MISHIN E KAFSHËVE TË LLOJIT
GJEDHË, TË IMTA, DERRA,
TË THERURA NË THERTORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 87/2012, datë 18.9.2012 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre”,



URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të certifikatës shëndetësore veterinare për mishin e kafshëve të llojit gjedhë, të imta, derra të therura në thertore bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Njësitë e qeverisjes vendore përgjegjëse për lëshimin e certifikatës shëndetësore veterinare për mishin e kafshëve të llojit gjedhë, të imta, derra të therura në thertore të marrin të gjitha masat për prodhimin dhe pajisjen me certifikatën veterinare sipas modelit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural dhe strukturat veterinare në njësitë e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi



CERTIFIKATË SHËNDETËSORE VETERINARE
Për mishin e kafshëve të llojit gjedhë, të imta, derra të therura në thertore

Nr. serial

Data e lëshimit ____ / ____ / ____

1. Identifikimi i kafshëve: Lloji: _____ Nr. i kafshëve: _____ Nr. matrikullit: _____	2. Certifikatë nr.: _____ 3. Shërbimi veterinar kompetent: _____ Nr. i vulës së miratuar: _____
4. Prejardhja e kafshëve: Adresa e fermës së origjinës: _____ Kodi i fermës: _____	5. Mjeti i transportit: _____ Pesha neto: _____, njësia: _____ Ora e lëvizjes __: __, data __ / __ / ____
6. Thertore: _____ Adresa: _____ Nr. i licencës (QKL): _____	7. Destinacioni i mishit Subjekti: _____ Adresa: _____

Informacion shëndetësor


Unë, i nënshkruari veterineri zyrtar deklaroj se:

- Kafshët u kontrolluan klinikisht përpara therjes në thertoren e sipërpërmendur në orën ____ (ora) më __ / __ / ____ (data) dhe u konstatua se:
 - a. janë të shëndetshme dhe vijnë nga ferma të pastra nga sëmundjet infektive dhe parazitare;
 - b. janë transportuar nga ferma e tyre në mjete, të pastruara dhe dezinfektuara përpara ngarkimit pa asnjë kontakt me kafshë të tjera që nuk plotësojnë kushtet referuar më sipër.
- Të dhënat e regjistruara dhe dokumentacioni lidhur me këto kafshë përmbushin kërkesat ligjore dhe nuk ndalojnë therjen e kafshëve.
- Ato u therën në thertore në orën ____ (ora) më __ / __ / ____ (data) ku therja dhe heqja e gjakut u kryen saktësisht.
- Kafshët përpara dhe gjatë therjes janë trajtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për mirqenien e kafshëve gjatë therjes.
- Mishi është për konsum human (pas kontrollit *ante* dhe *post-mortem* të kryer në përputhje me udhëzimin e ministrit nr. 23, datë 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”, si dhe karkasa ose pjesë të saj janë vulosur me vulë shëndetësore në përputhje me këtë udhëzim).
- Dispozita të veçanta: _____

Mjeku veterinar

Emri Mbiemri (me germa Kapitale),

Firma

**Shënime.**¹⁾ Të dhënat në këtë certifikatë plotësohet me germa kapitale dhe me bojë të ndryshme nga ngjyra e printimit.²⁾ Në rast se numri i kafshëve që shoqëron kjo certifikatë është më shumë se një, plotësohet aneksi bashkëngjitur.



CERTIFIKATË SHËNDETËSORE VETERINARE
Për mishin e kafshëve të llojit gjedhë, të imta, derra të therura në thertore

Aneks

Nr. serial

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Data e lëshimit ____ / ____ / ____

Nr.	Numër identifikimi i kafshëve									Lloji	Nr.	Numër identifikimi i kafshëve									Lloji
1	AL										21	AL									
2	AL										22	AL									
3	AL										23	AL									
4	AL										24	AL									
5	AL										25	AL									
6	AL										26	AL									
7	AL										27	AL									
8	AL										28	AL									
9	AL										29	AL									
10	AL										30	AL									
11	AL										31	AL									
12	AL										32	AL									
13	AL										33	AL									
14	AL										34	AL									
15	AL										35	AL									
16	AL										36	AL									
17	AL										37	AL									
18	AL										38	AL									
19	AL										39	AL									
20	AL										40	AL									

Veterineri zyrtar

Emri Mbiemri (me germa kapitale)-----
Firma

Vula

³⁾ Lloji do të shënohet me inicialet: G – gjedh; L – të leshta; D – të dhirta; P – derra;

**URDHËR****Nr. 190, datë 4.5.2018****PËR MIRATIMIN E CERTIFIKATËS
SHËNDETËSORE VETERINARE
QË SHOQËRON LËVIZJEN DHE
TRANSPORTIN E NGARKESAVE ME
LËKURË DHE PRODUKTE ME
ORIGINË SHTAZORE JO PËR
KONSUM NJERËZOR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55, pika 1, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të certifikatës shëndetësore veterinarë që shoqëron lëvizjen dhe transportin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të ngarkesave të produkteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Çdo ngarkesë me produkte me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor që lëvizin dhe transportohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të shoqërohet me certifikatë shëndetësore veterinarë sipas modelit të pikës 1, të këtij urdhri.

3. Institucionet përgjegjëse për lëshimin e certifikatës shëndetësore veterinarë që shoqëron lëvizjen dhe transportin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të ngarkesave me produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor sipas neneve 54 dhe 55, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të marrin të gjitha masat për prodhimin dhe pajisjen me certifikatën veterinarë sipas modelit të përcaktuar në pikën 1, të këtij urdhri.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Shërbimi Veterinar Rajonal dhe strukturat veterinarë në njësitë e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi




CERTIFIKATË SHËNDETËSORE VETERINARE

Që shoqëron lëvizjen dhe transportin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të ngarkesave me produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor

Nr.
serial

--	--	--	--	--	--	--	--

Data e lëshimit ____ / ____ / ____

1. Identifikimi i produktit: Lloji i produktit: _____ Nr. identifikimit (*) _____ Nr. i copëve: _____ Tipi i ambalazhit: _____ Pesha neto: _____, njësia: _____	2. Certifikatë nr.: _____
5. Prejardhja e kafshëve: Adresa e fermës së origjinës: _____ Kodi i fermës: _____ Mjeti i transportit: _____	3. Shërbimi Veterinar: _____ Nr. i vulës së miratuar: _____ 4. Vendi i origjinës Thertore/ stabiliment përpunimi _____ Nr. i miratimit: _____ 6. Marrësi Emri: _____ Adresa: _____
Informacion shëndetësor Unë, i nënshkruari veterineri zyrtar deklaroj, se: - Produkti origjinën nga kafshë të shëndetshme, të cilat i janë nënshtruar kontrollit veterinar <i>ante</i> dhe <i>post-mortem</i> dhe kanë rezultuar të pastra nga sëmundjet infektive në kafshë dhe njerëz dhe mishi i tyre është konsideruar i përshtatshëm për konsum njerëzor. - Produktet janë grumbulluar nga thertore/stabilimente përpunimi të miratuara të cilat janë nën kontroll të vazhdueshëm, kanë vulën e kontrollit veterinar dhe janë përgatitur, manipuluar dhe transportuar në përputhje me rregullat dhe normat e higjienës sanitaro-veterinare. - Produktet i janë nënshtruar dezinfektimit apo sterilizimit dhe nuk përmbajnë mikroorganizma patogjenë për kafshë e njerëz. - Dispozita të veçanta: _____	
Veterineri zyrtar: _____ Emri Mbiemri (me germa Kapitale), Firma  Vula	

(*) Kur numri i kafshëve është më shumë se 1 (një) numrat e identifikimit jepen në aneksin bashkëngjitur kësaj certifikate.


 Nr.
serial

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Data e lëshimit ____ / ____ / ____

Nr.	Numër identifikimi i kafshëve									Lloji	Nr.	Numër identifikimi i kafshëve									Lloji
1	AL										21	AL									
2	AL										22	AL									
3	AL										23	AL									
4	AL										24	AL									
5	AL										25	AL									
6	AL										26	AL									
7	AL										27	AL									
8	AL										28	AL									
9	AL										29	AL									
10	AL										30	AL									
11	AL										31	AL									
12	AL										32	AL									
13	AL										33	AL									
14	AL										34	AL									
15	AL										35	AL									
16	AL										36	AL									
17	AL										37	AL									
18	AL										38	AL									
19	AL										39	AL									
20	AL										40	AL									

Veterineri zyrtar

 Emri Mbiemri (me germa kapitale)

 Firma

Vula

Lloji do të shënohet me inicialet: G – gjedh; L – të leshta; D – të dhirta; P – derra;

**VENDIM****Nr. 80, datë 4.5.2018****AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “PËR NXITJEN E
PUNËSIMIT TË TË RINJVE NGA
GRUPE TË VEÇANTA”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- z. Arben Ahmetaj kryetar;
- znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- z. Ahmet Mançellari anëtar;

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 4.5.2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore” i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, mori në shqyrtim njoftimin e Bashkisë Tiranë lidhur me planin e dhënies së ndihmës shtetërore për nxitjen e punësimit të të rinjve nga grupe të veçanta.

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë me shkresën nr. 10964, datë 13.3.2018 në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar njoftoi në Komisionin e Ndhmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 132, datë 21.12.2017, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018–2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”.

II. Përshkrimi i masës

2. Objektivi: Planin e ndihmës ka si objektivi punësimin e të rinjve, kryesisht të të rinjve pjesëtarë të familjeve që përfshihen në skemën e ndihmës ekonomike dhe grupeve të disavantazhuara, duke i mbështetur me grant të drejtpërdrejtë të planifikuar dhe të miratuar në buxhetin e Bashkisë së Tiranës, për të mundësuar integrimin e të rinjve në tregun e punës.

3. Baza ligjore: Planin e ndihmës shtetërore është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 132, datë 21.12.2017 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018–2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”, në programin e III “Kujdesi social dhe solidariteti”, nën zëri

“Projekti “Të rinj dhe të reja drejt një profesioni”, në vlerën 5.000.000 lekë.

4. Kohëzgjatja: Planin e ndihmës do të zbatohet në vitin 2018 dhe do të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare deri në vitin 2020.

5. Dhënësi i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Tiranës.

6. Përfituesit: Përfitues janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Bashkisë së Tiranës, që punësojnë të rinjtë nga grupe të veçanta. Planin e ndihmës shtetërore do të zbatohet në të gjithë sektorët e ekonomisë duke synuar mbështetjen me grante për 11 deri në 50 ndërmarrje.

7. Shtrirja territoriale: Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës.

8. Forma dhe vlera e ndihmës: Vlera e ndihmës për vitin 2018 është 5.000.000 (pesë milionë) lekë në formën e grantit të drejtpërdrejtë nga fondet e miratuara për Bashkinë e Tiranës.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson nëse planin e ndihmës shtetërore për nxitjen e biznesit rinor, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse planin ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”

11. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve



Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

12. Sa më lart, ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, më konkretisht: a) burime shtetërore, b) avantazhi ekonomik, c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Bashkia e Tiranës, ka njoftuar planin e ndihmës shtetërore, e cila lidhet me aktivizimin e burimeve shtetërore në formën e pagesës në nivelin e pagës minimale bruto të një numri të caktuar të të rinjve pjesëtarë të familjeve që përfshihen në skemën e ndihmës ekonomike dhe grupeve të disavantazhuara, me qëllim punësimin e tyre në 11 deri në 55 ndërmarrje të ndryshme në territorin e bashkisë. Plani i ndihmës së njoftuar ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se përmirëson situatën ekonomike të ndërmarrjeve që punësojnë të rinjtë, kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson se në bazë të nenit 10, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, ndihma shtetërore për punësim mund të lejohet nëse jepet për:

“a) punësimin e punëkërkuesve të papunë në vështirësi, në formën e subvencionit të pagës, të sigurimeve të detyrueshme shoqërore e shëndetësore dhe kostove të trajnimit”

15. Bashkia e Tiranës nëpërmjet planit të njoftuar të ndihmës, synon nxitjen e punësimit të të rinjve të papunë nga grupe të veçanta, të cilët kanë vështirësi në hyrjen në tregun e punës.

Ndihma shtetërore në formën e subvencionimit të kostos së pagave/pagës minimale bruto, ofron stimuj shtesë për ndërmarrjet për të përmirësuar aktivitetin e tyre ekonomik nëpërmjet punësimit të punëkërkuesve të pafavorizuar. Pra, qëllimi i planit të njoftuar të ndihmës është të inkurajojë rekrutimin e kategorive të punonjësve nga këto grupe të veçanta dhe përmirësimin e standardit të jetesës.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm dhe në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, nenin 10 “Ndhma shtetërore për punësim”, pika 1, shkronja a), sepse të gjithë kategoritë e punëkërkuesve të disavantazhuar do të mund të integrohen në tregun e punës dhe një pjesë burimeve shtetërore të bashkisë do të rishpërndahen drejt tyre, me qëllim hyrjen në tregun e punës apo për të qëndruar në tregun e punës.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 10, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e planit të ndihmës shtetërore në formën e mbështetjes financiare për punësimin e të rinjve nga grupe të veçanta, të miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak, Tiranë, nr. 132, datë 21.12.2017 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018–2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2018”.

2. Bashkia e Tiranës në zbatimin e planit të ndihmës shtetërore, duhet:

- të sigurojë që punonjësit e rekrutuar nga grupet e disavantazhuara të plotësojnë vetëm vendet vakant të punës ose vendet e reja të hapura të punës;

- të ndalojë dhënien e ndihmës shtetërore për plotësimin e vendeve të punës që krijohen rishtas apo për zëvendësimin e punëtorëve të larguar nga ndërmarrja;

- të raportojë në Komisionin e Ndhmës Shtetërore ekzistencën e efektit nxitës dhe domosdoshmërinë e ndihmës. Për këtë arsye

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



është e nevojshme që ndërmarrja përfituese duhet të paraqesë më parë një kërkesë për ndihmë shtetërore në Bashkinë e Tiranës dhe është e interesuar përpara punësimit të punëkërkuësve nga kategoritë e punonjësve të përfshirë në planin e ndihmës;

- të sigurojë se ndihma jepet për punësimin e personave të pafavorizuar në një ndërmarrje.

3. Bashkia e Tiranës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ahmetaj

VENDIM **Nr. 81, datë 4.5.2018**

AUTORIZIM I NDIHMËS **SHTETËRORE “PËR NXITJEN E** **BIZNESIN RINOR”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- z. Arben Ahmetaj kryetar;
- znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- z. Ahmet Maçellari anëtar;

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 4/5/2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, mori në shqyrtim njoftimin e Bashkisë Tiranë lidhur me planin e dhënies së ndihmës shtetërore për krijimin dhe nxitjen e biznesit rinor.

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë me shkresën nr. 10964, datë 13.3.2018, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar njoftoi në Komisionin e Ndhmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të

sipërpërmendur, në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 132, datë 21.12.2017, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018–2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”.

II. Përshkrimi i masës

2. Objektivi: Plani i ndihmës ka si objektiv punësimin e të rinjve, duke i mbështetur me grant të drejtpërdrejtë të planifikuar dhe të miratuar në buxhetin e Bashkisë së Tiranës, për të krijuar biznese të reja apo për të zgjeruar bizneset ekzistuese.

3. Baza ligjore: Plani i ndihmës shtetërore është miratuar më vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 132, datë 21.12.2017, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018–2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”, në programin III “Kujdesi social dhe solidariteti”, nën zëri “Projekti “Programi i nxitjes së punësimit të Biznesit Rinor”, në vlerën 10.000.000 lekë.

4. Kohëzgjatja: Plani i ndihmës do të zbatohet në vitin 2018 dhe do të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare deri në vitin 2020.

5. Dhënësi i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Tiranës.

6. Përfituesit: Përfitues janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme në territorin e Bashkisë së Tiranës. Plani i ndihmës shtetërore do të zbatohet në të gjithë sektorët e ekonomisë duke synuar mbështetjen me grante për 11 deri në 50 ndërmarrje.

7. Shtrirja territoriale: Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës.

8. Forma dhe vlera e ndihmës: Vlera e ndihmës për vitin 2018 është 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë në formën e grantit të drejtpërdrejtë nga fondet e miratuara për Bashkinë e Tiranës. Buxheti i miratuar për vitin 2019 është 11 130 000 lekë, për vitin 2020 është 11 130 000 lekë.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore për nxitjen e biznesit rinor, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe



tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”

11. Gjithashtu neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë², përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87, të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

12. Sa më lart, ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, më konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

Burimet shtetërore

13. Në këtë njoftim granti i drejtpërdrejtë do të jepet nga burime shtetërore. Ndërmarrjet përfituese kanë avantazh ekonomik, kundrejt ndërmarrjeve të tjera, pasi ato do të përfitojnë nga fondet e Bashkisë së Tiranës një ndihmë financiare, që në kushte normale të zhvillimit të veprimtarisë së tyre nuk do të mund ta siguronin.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

14. Skema e ndihmës ka karakter selektiv,

sepse prej saj përfitojnë një numër i kufizuar ndërmarrjesh mikro dhe të vogla, që plotësojnë kushtet e përcaktuara, dhe të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre tregtare në hapësirën territoriale administrative të Bashkisë së Tiranës. Pra, jo të gjitha ndërmarrjet që operojnë në treg kanë aftësinë për të aplikuar dhe përfituar nga mbështetja financiare.

Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti

15. Masa e ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg.

Konkluzion

Sa më sipër, duke qenë se skema aktivizon burime shtetërore, i ofron ndërmarrjeve përfituese një avantazh ekonomik dhe se ka efekt në konkurrencë dhe tregti, Komisioni shprehet se plani i mbështetjes së biznesit rinor me grante nga Bashkia e Tiranës është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

16. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se neni 8, i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, parashikon se:

“1. Ndihma “de minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”

17. Në bazë të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016 “Për përcaktimin e vlerës maksimale, kushteve dhe procedurës për dhënien e ndihmës “de minimis”, kreu IX, për matjen dhe kontrollin e zbatimit të skemës, dhënësi dhe përfituesi i ndihmës “de minimis” ka detyrimet si vijon:

1. Dhënësi i ndihmës “de minimis” i kërkon ndërmarrjes një deklaratë mbi çdo ndihmë “de minimis” të përftuar gjatë dy viteve të kaluara dhe vitit financiar në vazhdim. Ndërmarrja përfituese e ndihmës nënshkruan deklaratën, sipas modelit të miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

2. Dhënësi vendos të japë ndihmën “de minimis” vetëm nëse shuma e ndihmës së re nuk i kalon vlerat maksimale të caktuara në këtë vendim, duke marrë parasysh shumat e mëparshme të ndihmës “de minimis”.

² Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



3. Dhënësi informon përfituesin e ndihmës për shumën e grantit në të holla ose për ekuivalentin bruto të grantit dhe të karakterit “de minimis”, duke përdorur formularin përkatës, sipas modelit të miratuar me vendim të Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

4. Dhënësi dhe përfituesi njoftojnë, menjëherë, ndihmën “de minimis” pranë strukturës përgjegjëse për kontrollin e ndihmës shtetërore, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë (në vijim struktura).

18. Një ndërmarrje është subjekt i ndihmës “de minimis” i skemave të tjera të miratuara nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore. Në bazë të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, kushteve dhe procedurës për dhënien e ndihmës “de minimis”, kreu II ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milion) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi.

b) Ndhma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Për këtë arsye, Komisioni vendos t’i kërkohej çdo përfituesi një deklaratë për çdo ndihmë “de minimis” të përfituar nga të gjitha skemat e ndihmës shtetërore gjatë dy viteve të kaluara dhe vitin financiar në vazhdim, për të kontrolluar nëse ndihma gjithsej nuk e kalon vlerën e ndihmës “de minimis” të lejuar.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm dhe në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 8 “Ndhma de minimis”, sepse nuk do të kalojë vlerën maksimale të lejuar për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e planit të ndihmës shtetërore nëpërmjet mbështetjes financiare të biznesit rinor, të miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 132, datë 21.12.2017, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018–2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”.

2. Bashkia e Tiranës të përcaktojë kriteret si më poshtë:

- përfituesit potencial nga plani i ndihmës;
- kategorinë e aktiviteteve të cilat kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë;
- vlerën minimale dhe maksimale të mbështetjes me ndihmë shtetërore; si edhe
- të listojë kostot e pranueshme për të cilat jepet ndihmë shtetërore.

3. Bashkia e Tiranës të përcaktojë indikatorët për matjen e performancës dhe impaktit, me qëllim monitorimin e ndihmës shtetërore, ku duhet të jenë përfshirë elementet, si:

- përshkrimi i detajuar i kostove të pranueshme;
- dorëzimi i raporteve financiare;
- monitorimi i ndihmës së dhënë, me qëllim përmbushjen e objektivave për të cilat është miratuar si edhe përmbushja e termave të kontratës;
- njohja e shpenzimeve vetëm mbi bazën e faturave të dorëzuara;
- kthimi i ndihmës në rast të konstatimit të parregullsive në përdorimin e ndihmës.

4. Bashkia e Tiranës gjatë zbatimit të planit të ndihmës shtetërore:

a) T’i kërkojë çdo përfituesi një deklaratë mbi çdo ndihmë “de minimis” të përfituar gjatë dy viteve të kaluara dhe vitin financiar në vazhdim. Ndërmarrja përfituese e ndihmës do të nënshkruajë deklaratën, sipas modelit të miratuar me vendimin e Komisioni i Ndhmës Shtetërore nr. 67, datë 25.10.2016, “Për miratimin e deklaratës së dhënies së ndihmës de minimis”;



b) Të japë ndihmën “de minimis” vetëm nëse shuma e ndihmës së re nuk i kalon vlerat maksimale të caktuara në këtë vendim, duke marrë parasysh shumat e mëparshme të ndihmës “de minimis”;

c) Së bashku me përfituesin të njoftojnë menjëherë për ndihmën “de minimis” në strukturën përgjegjëse për kontrollin e ndihmës shtetërore, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

5. Bashkia e Tiranës të përmbushë objektivin për të cilin miratohet dhënia e ndihmës, duke synuar mbështetjen me ndihmë shtetërore të 11 deri në 50 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

6. Bashkia e Tiranës brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

7. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

8. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ahmetaj

NJOFTIM

Nr. 8145, datë 17.5.2018

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES ME ITALINË

“Ndryshimin me shkëmbim notash, të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit “Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave”, nënshkruar më 9.5.2016, hyrë në fuqi më 11.5.2018.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

NJOFTIM

Nr. 8259, datë 18.5.2018

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES ME ITALINË

“Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë për mbrojtjen shoqërore”, nënshkruar në Bukuresht, më 27.2.2015, ka hyrë në fuqi më 1.10.2016.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

URDHËR

Nr. 64, datë 22.5.2018

PËR PËRFITIMIN DHE PËRDITËSIMIN E NJOHURIVE SHITESË NË PROCESIN E VLERËSIMIT TË REZULTATEVE NË PUNË

Në mbështetje të nenit 25, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; bazuar në frymën e VKM-së nr. 125, datë 7.3.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 1037, datë 16.12.2015, “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”, të vendimit nr. 85, datë 30.6.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit administrativ të KLSH-së dhe në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, ISSAI 100, ISSAI 30, ISSAI 40 dhe Programit të Zhvillimit Profesional të KLSH-së,

URDHËROJ:

1. Kryerjen e vlerësimeve sistematike mbi procesin e përfitimit dhe përditësimit të njohurive shtesë të audituesve/ nëpunësve civilë, i cili synon aftësimin dhe pajisjen e tyre me njohuritë shtesë të nevojshme, sipas funksioneve dhe fushës ku ata veprojnë, me qëllim ngritjen e cilësisë së veprimtarisë audituese në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

2. Zhvillimin e testimit paraprak dhe, kur është e nevojshme, trajnimin e audituesve/ nëpunësve civilë për njohuritë e reja që prekin fushën e tyre. Në përfundim të trajnimit bëhet testimi me shkrim në lidhje me njohuritë e përfituara gjatë trajnimit.



Objektivat kryesorë të këtij procesi, janë:

- përcaktimi i përshtatshmërisë së audituesit/ nëpunësit civil me pozicionin e punës që ai mban;

- zbulimi i aftësive të audituesit/ nëpunësit civil për zhvillimin profesional;

- përcaktimi i nevojave për trajnime shtesë.

3. Çdo auditues/ nëpunësit civil, është i detyruar t'i nënshtrohet periodikisht testimit paraprak dhe, kur është e nevojshme, procedurës së trajnimit të veçantë për këtë testim çdo 4 vjet. Nuk i nënshtrohen kësaj procedure:

a) Auditues/nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese;

b) Auditues/nëpunësit civilë në periudhë prove;

c) Auditues/nëpunësit civilë, të cilët janë të pezulluar;

ç) Auditues/nëpunësit civilë, të cilët janë me leje lindjeje;

d) Auditues/nëpunësit civilë në vitin e fundit të punës, përpara mbushjes së moshës së pensionit.

4. Audituesit/nëpunësit civilë sipas shkronjave “c”, “ç”, të pikës 3, të këtij urdhri, i nënshtrohen kësaj procedure, përkatësisht, 1 vit pas sistemimit të tyre në një pozicion pune, 1 vit pas përfundimit të lejes së lindjes.

5. Mosparaqitja e audituesve/ nëpunësve civilë në testimin paraprak apo testimin në përfundim të trajnimit, pa shkaqe të arsyeshme, konsiderohet shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligjin e nëpunësit civil dhe ligjin nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së” dhe përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore.

6. Në kuptim të pikës 5 të këtij urdhri, shkaqe të arsyeshme konsiderohen:

- rastet e sëmundjeve të nëpunësit civil apo fëmijëve të mitur vërtetuar me raport mjekësor;

- martesa e nëpunësit civil;

- martesa e fëmijës së tij;

- vdekja e prindërve, gjyshërve, bashkëshortit/es, fëmijës, vëllezërve, motrave;

- sëmundjet e rënda të fëmijëve, prindërve, bashkëshortit/es, të vërtetuar me raport mjekësor;

- rastet e trajnimit jashtë vendit të nëpunësve civilë, për një periudhë me të gjatë se 1 muaj, të organizuar nga institucioni.

7. Audituesit/nëpunësit civilë, të cilët nuk paraqiten në testimin paraprak apo në testimin në përfundim të trajnimit për shkaqet e arsyeshme të përcaktuara sipas pikës 6, të këtij urdhri, janë të detyruar t'i nënshtrohen procedurës së testimit, si më poshtë vijon:

- në rastet e testimit paraprak, brenda 3 muajve, nga data e rikthimit në punë;

- në rastet e testimit në përfundim të trajnimit, brenda 1 muaji, nga data e rikthimit në punë.

8. Grupet e pozicioneve, për të cilat do të zhvillohet procesi i vlerësimit për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë, miratohen nga kryetari i KLSH-së, me propozimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore e Sekretarit të Përgjithshëm dhe drejtorëve të përgjithshëm, brenda *muajit maj të vitit 2018*. Për vitet pasardhëse, ky proces do të kryhet brenda *muajit shkurt të çdo viti*.

9. Fushat e njohurive, për të cilat do të zhvillohet procesi i vlerësimit për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë, do të përcaktohen brenda *muajit maj të vitit 2018* nga Departamenti i Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Për vitet pasardhëse, ky proces do të kryhet brenda *muajit shkurt të çdo viti*.

10. Brenda *muajit maj të vitit 2018*, Departamenti i Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore harton programet e trajnimit për fushat e përcaktuara. Programet dhe mënyra e zhvillimit të tyre miratohen nga kryetari dhe duhet të zgjasin 10 deri në 20 ditë. Për vitet pasardhëse ky proces do të kryhet brenda *muajit mars të çdo viti*.

11. Brenda *muajit maj të vitit 2018*, Departamenti i Strategjisë e Metodologjisë së Auditimit, në bashkëpunim me departamentet e auditimit e strukturat e tjera të KLSH-së bazuar në Programin e Zhvillimit Profesional të punonjësve të KLSH-së, harton planin e trajnimit për fushat e përcaktuara. Për vitet pasardhëse ky proces do të kryhet brenda *muajit mars të çdo viti*.

12. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, brenda *muajit qershor të vitit 2018*, publikon në faqen zyrtare të KLSH-së kalendarin vjetor të testeve paraprake për secilin nga grupet e përcaktuara sipas pikës 8, të këtij urdhri. Për vitet pasardhëse ky proces do të kryhet brenda *muajit mars të çdo viti*.



13. Brenda *muajit maj të vitit 2018*, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, harton listat e audituesve/ nëpunësve civilë, të cilët do t'i nënshtrohen kësaj procedure dhe, bazuar në dosjet e në përshkrimet e tyre të punës, kryen ndarjen në grupe të përbashkëta. Në këto grupe marrin pjesë audituesit/nëpunësit civilë që kanë përshkrime pune të njëjta/të përafërta dhe kohë të përafërt punësimi në KLSH. Për vitet pasardhëse ky proces do të kryhet brenda *muajit prill të çdo viti*.

14. Të gjithë audituesit/ nëpunësit civilë, të grupuar sipas këtij urdhri, i nënshtrohen *procedurës së testimit paraprak*.

Testimi paraprak duhet të përfshijë të gjitha *ndryshimet dhe të rejat që i përkasin fushës përkatëse*, sipas grupimit, të cilit i përket audituesi/nëpunësi civil, dhe të përcaktuara sipas pikës 9, të këtij urdhri.

15. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me departamentet/drejtoritë përkatëse të auditimit, pas përcaktimit të listave të audituesve/nëpunësve civilë sipas pikës 13, të këtij urdhri, njofton këta nëpunës *brenda muajit maj*.

16. Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentin e Strategjisë dhe Metodologjisë përcaktojnë *datën e testimit paraprak* për çdo grupim. Audituesit/nëpunësit, që do t'i nënshtrohen testimit paraprak, njoftohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të paktën, *një muaj përpara datës së përcaktuar* për zhvillimin e testimit nëpërmjet shpalljes në faqen zyrtare të internetit të KLSH-së.

17. Audituesit/nëpunësit civil i vihet në dispozicion, nga Departamenti i Strategjisë dhe Metodologjisë, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të internetit të KLSH-së, fusha e njohurive, mbi bazën e së cilës do të zhvillohet testimi, dhe materialet ose referencat përkatëse, të paktën 20 (njëzet) ditë përpara zhvillimit të testimit.

18. Testimi paraprak i nëpunësve civilë realizohet nga Komisioni i Vlerësimit (KV), me përbërje si më poshtë vijon:

a) Një përfaqësues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të KLSH-së, i cili bashkë kryeson komisionin;

b) Një përfaqësues nga ASPA-ja;

c) Nëpunësi më i lartë civil i KLSH-së, i cili bashkëkryeson komisionin;

d) Drejtori i përgjithshëm ose drejtorët e përgjithshëm;

e) Dy ekspertë të fushës;

f) Drejtori i Departamentit të Strategjisë dhe Metodologjisë.

- Ekspertët zgjidhen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, për secilin Komision të Vlerësimit, duke pasur në konsideratë karakteristikat e secilit grup nëpunësish për të cilët do të zhvillohet procedura e vlerësimit. Ekspertët zgjidhen sipas procedurave referuar vendimit të kryetarit nr. 61, datë 9.5.2015 “Për rregullat dhe procedurat e përzgjedhjes kontraktimit dhe pagesës së ekspertëve të përkohshëm të jashtëm të KLSH-së”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76/2015.

19. Vlerësimi i audituesve/ nëpunësve civilë, të cilët i nënshtrohen procedurës, bëhet nëpërmjet testimit me shkrim. Për vlerësimin e rezultateve për secilin auditues/ nëpunës, secili prej anëtarëve jep pikët e tij. Në përfundim, pikët mbledhen dhe më pas nxirret mesatarja e përgjithshme, e cila përbën edhe vlerësimin përfundimtar të kandidatit. Vlerësimi maksimal është 100 pikë.

- KV-ja, bazuar në fushën e njohurive, për të cilat do të zhvillohet testimi, përgatit pyetjet për testimin me shkrim. KV-ja, brenda 2 ditëve nga përfundimi i procedurës së vlerësimit, duhet të shpallë rezultatet sipas kësaj skeme:

a) 90–100 pikë “shumë mirë”;

b) 70–89 pikë “mirë”;

c) 51–69 pikë “kënaqshëm”

ç) 0–50 pikë “jokënaqshëm”.

20. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, harton listat e audituesve/ nëpunësve civilë që i janë nënshtrohur procedurës së testimit paraprak, së bashku me vlerësimet përkatëse:

a) Audituesit/ nëpunësit civilë që janë vlerësuar “shumë mirë” konsiderohen të përshtatshëm për pozicionin e punës që kanë dhe rekomandohen për ngritje në detyrë, në rast se aplikojnë në një procedurë të tillë konkurrimi. Ata nuk kanë nevojë t'i nënshtrohen procedurës së trajnimit, por përgjatë vitit zhvillojnë leksione trajnimi.

b) Audituesit/ nëpunësit civilë që janë vlerësuar “mirë” konsiderohen të përshtatshëm për pozicionin e punës ku janë caktuar. Ata nuk kanë nevojë t'i nënshtrohen procedurës së trajnimit, për këtë vlerësim por kryejnë trajnimin e vazhdueshëm vjetor në KLSH.



c) Audituesit/ nëpunësit civilë që janë vlerësuar “kënaqshëm” konsiderohen të përshtatshëm për pozicionin e punës ku janë caktuar, me kushtin që të ndjekin programe trajnimi të vazhdueshme, të cilat synojnë plotësimin e dobësive që kanë shfaqur gjatë kësaj procedure.

Përcaktimi i fushave ku duhet të trajnohen audituesit/nëpunësit, bëhet nga eprori direkt, në bashkëpunim me Departamentin e Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Programi i trajnimit, për këta nëpunës, hartohet nga Departamenti i Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit bazuar në Raportin e Komisionit të Vlerësimit. Ky program miratohet nga kryetari dhe rekomandimet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Ndjekja e programeve të trajnimit duhet të realizohet brenda një viti, nga përfundimi i procedurës së testimit paraprak. Ky program përfshihet në programin e detyrueshëm të trajnimit vjetor në KLSH.

Në përfundim të këtyre trajnimeve audituesit/nëpunësit civilë të vlerësuar “kënaqshëm” nuk i nënshtrohen testeve të reja.

ç) Audituesit/nëpunësit civilë që janë vlerësuar “jokënaqshëm” konsiderohen *jo të përshtatshëm* për pozicionin e punës ku janë caktuar. Ata janë të detyruar të ndjekin trajnimin për këtë qëllim për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë, si dhe i nënshtrohen një testimi të dytë.

21. Brenda 10 ditëve, nga përfundimi i testimit me shkrim, Drejtoria e Burimeve Njerëzore u njofton audituesve/nëpunësve civilë, të cilët i janë nënshtuar procedurës, rezultatin e testimit me shkrim.

22. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 21, të këtij urdhri, Drejtoria e Burimeve Njerëzore i vë në dispozicion *kryetarit* të dhënat mbi audituesit/nëpunësit e vlerësuar “kënaqshëm” dhe “jokënaqshëm”.

23. Audituesit/nëpunësit civilë e vlerësuar “jokënaqshëm”, në procedurën e parë të vlerësimit, i nënshtrohen një periudhe vlerësimi 3-mujore, si edhe procedurës së trajnimit për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë. Periudha 3-mujore e vlerësimit fillon 10 ditë pas përfundimit të testimit paraprak. Procedura e vlerësimit 3-mujor bëhet sipas rregullave dhe formave që parashikon vendimi i Këshillit të

Ministrave për vlerësimin e rezultateve në punë. Në përfundim të kësaj procedure, audituesi/nëpunësi civil duhet të jetë vlerësuar, të paktën “kënaqshëm”.

24. Brenda 5 ditëve, nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 21, të këtij urdhri, Departamenti i Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit njofton audituesit/nëpunësit civilë të vlerësuar “jokënaqshëm” për kalendarin e zhvillimit të trajnimit, duke iu vënë në dispozicion programet e trajnimit dhe materialet përkatëse. Në çdo rast, këto trajnime të zhvillohen brenda gjysmës së parë të periudhës 3-mujore të vlerësimit.

24.1 Trajnimi (i cili mund të ndiqet dhe online) organizohet sipas Programit dhe afatit të përgatitur nga Departamenti i Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit, i cili miratohet nga kryetari.

24.2 Pjesëmarrja e audituesve/nëpunësve civilë në trajnim është e detyrueshme, në masën 75 (shtatëdhjetë e pesë) për qind. Mosrespektimi i kësaj dispozite pa shkaqe të arsyeshme konsiderohet shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil dhe kuadrin ligjor të KLSH-së, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore. Në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi të përcaktuar, për një nga shkaqet e arsyeshme sipas pikës 7, të këtij urdhri, audituesi/nëpunësi civil është i detyruar të ndjekë nga fillimi trajnimin përkatës, brenda 3 muajve, nga data e rikthimit në punë.

24.3 Me përfundimin e trajnimit, nëpunësi i nënshtrohet testimit nga Komisioni i Vlerësimit.

Testimi i audituesve/nëpunësve civilë, të cilët kanë përfunduar trajnimin, realizohet nga i njëjti Komision Vlerësimi (KV) që ka zhvilluar procedurën e testimit paraprak ose me ndryshime pjesore në Komision. Vlerësimi i audituesve/nëpunësve civilë, të cilët i nënshtrohen procedurës, bëhet nëpërmjet testimit me shkrim sipas përcaktimeve të pikës 19, të këtij urdhri.

24.4 Drejtoria e Burimeve Njerëzore harton listat e audituesve/ nëpunësve civilë, të cilët i janë nënshtuar testimit, në përfundim të trajnimit, së bashku me vlerësimet përkatëse.

24.5 Audituesit/nëpunësit civilë që janë vlerësuar “shumë mirë” dhe “mirë” konsiderohen të përshtatshëm për pozicionin e punës që kanë dhe nuk u nënshtrohen testeve të reja.

24.6 Nëpunësit që janë vlerësuar “kënaqshëm” konsiderohen të përshtatshëm për pozicionin e



punës ku janë caktuar, me kushtin që të ndjekin programe trajnimi të tjera, të cilat synojnë plotësimin e dobësive që kanë shfaqur gjatë kësaj procedure dhe nuk u nënshtrohen testeve të reja.

24.7 Audituesit/nëpunësit civilë që janë vlerësuar “jokënaqshëm” konsiderohen se nuk e kanë kaluar testimin pranë KV-së.

24.8 Në përfundim të procedurave të mësipërme, audituesi/nëpunësi civil vlerësohet jo i përshtatshëm me vendin e punës në rastin kur si rezultati në përfundim të periudhës së vlerësimit 3-mujor, edhe rezultati i testimit me shkrim, në përfundim të trajnimit, janë “jokënaqshëm”.

24.9 Në rast se audituesi/ nëpunësi civil vlerësohet jo i përshtatshëm me vendin e punës, atëherë Drejtoria e Burimeve Njerëzore *deklaron përfundimin e marrëdhënieve në Shërbimin Civil*.

25. Në asnjë rast, ky urdhër nuk cenon trajnimet e vazhdueshme vjetore që zhvillohen përgjatë vitit në KLSH. Çdo drejtues, auditues/nëpunës civil duhet të zhvillojë 15–25 ditë trajnimi në vit brenda ose jashtë institucionit apo vendit.

26. Ngarkohen drejtori i Burimeve Njerëzore, Sekretari i Përgjithshëm, drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e departamenteve/ drejtorive dhe i gjithë stafi i KLSH-së, për zbatimin e këtij urdhri.

27. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Në rast se urdhri do të botohet jo në muajin maj 2018, por në muajin qershor 2018 të gjitha etapat shtyhen me një muaj.

KRYETAR
Bujar Leskaj

KËRKESË

Shtetasi Urim Zekolli, i datëlindjes 6.9.1961, lindur në Korçë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Razmi Zekolli, i datëlindjes 6.3.1928.

KËRKUES
Urim Zekolli

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë